



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 1420 / Prot.  
3

Tiranë, më 01 / 01 / 2020

URDHËR

Nr. 63, datë 01 .07.2020

PËR

**“PEZULLIMIN E REKRUTIMIT TË PERSONELIT NË UNIVERSITETIN E  
MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 39 e vijues si dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, 28 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 175, datë 30.06.2020 “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe me qëllim evitimin e të gjitha vendimeve që mund të dëmtojnë integritetin e zgjedhjeve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

URDHËROJ:

1. Të pezullohet çdo veprim administrativ që ka lidhje me rekrutimin e personelit akademik, ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Për pozicionet e punës të shpallura në Buletinet e Agjencisë së Prokurimit Publik, përpara daljes së këtij Urdhri, strukturat përgjegjëse në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, do të respektohen afatet e parashikuara në këto buletine vetëm për pranimin e dokumentacionit.
3. Ky urdhër i shtrin efektet e tij deri në dekretimin dhe emërimin e autoriteteve që do të dalin nga zgjedhjet universitare të vitit 2020 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, struktura përgjegjëse në Rektoratin e UMT-së dhe Njesisë Kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**

